



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**



V E N D I M

Nr. 71, date 02.10.2018

**PËR NJË SHITESË NË VKB NR. 62, DATË 20.08.2018 “PËR MIRATIMIN E
KËRKESËS SË BASHKISË SHKODËR, SË BASHKU ME DOKUMENTACIONIN
TEKNIKO LIGJOR PËR AKORDIMIN E NDIHMËS FINANCIARE PËR
FAMILJET E Z. JAKO DANI, PJETËR, ERVIN, FRANC PJETRA, BANESAT E
TË CILËVE JANË DËMTUAR NGA ZJARRI”**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e datës 02.10.2018, me propozim të kryetarit të bashkisë, mbështetur në nenet 54 shkronja “dh”, 55 pika 3 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 8756, datë 26.03.2001 “Për emergjencat civile”, të ndryshuar, VKM nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave nr. 263, datë 24.05.2013 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve ndërtimore të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, VKB nr. 85, datë 26.12.2017 “Për buxhetin e Bashkisë Shkodër për vitin 2018”, Shkresa nr. 3950 prot, datë 21.06.2017 e Ministrisë së Punëve të Brendshme,

V E N D O S I :

1. Miratimin e shtesës në VKB nr. 62, datë 20.08.2018 “Për miratimin e kërkesës së bashkisë Shkodër, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjet e z. Jako Dani, Pjetër, Ervin, Franc Pjetra, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga zjarri”, si më poshtë:

Ishte:

Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për dhënien e ndihmës së menjëhershme financiare familjes së z. **Ervin Pjetra** (3 anëtarë familje) në vlerën prej **60.000 lekë** (gjashtëdhjetë mijë), për dëmtimin e banesës nga zjarri.

Bëhet:

Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për dhënie e ndihmës së menjëhershme financiare familjes së z. **Ervin Pjetra** (4 anëtarë familje) në vlerën prej **80.000 lekë** (*tetëdhjetë mijë*), për dëmtimin e banesës nga zjarri.

2. Burimi i financimit do të jetë fondi i emergjencave civile në programin 10910 parashikuar në buxhetin e bashkisë Shkodër për vitin 2018 të miratuar me VKB nr.85, datë 26.12.2017, në programin P13, F1 O1 A2. (transferime për individë).
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Miratuar në datën 2.10.2018


Shpallur në datën 8.10.2018

Sekretar i keshillit



Suel Hadri

KRYETAR



Xhemal BUSHATI

